

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
Ministrit, z. Memli KRASNIQI

Prishtinë, 26 shtator 2012

Kërkesë për valorizimin e figurës së poetit Ali Podrimja

I nderuar zoti Ministër,

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, sikundër e kemi bërë të ditur edhe më parë, ka marrë përsipër përkujdesjen për valorizimin e veprës dhe të figurës së poetit Ali Podrimja. Në këtë kuadër, Akademia është duke bërë përgatitjet për botimin e veprës së plotë të poetit Podrimja në disa vëllime dhe, bashkë me këtë, për gjetjen e formës më të përshtatshme, në bashkëpunim me institucionet e Kosovës, për valorizimin e figurës së poetit të shquar. Vitin e ardhshëm, në përvjetorin e vdekjes, do të ishte e përshtatshme që, bashkë me promovimin e kompletit të veprave dhe të inaugurimit eventual të bustit të Ali Podrimjes në ndonjë lokacion të përshtatshëm të qytetit të Prishtinës, të bëhet edhe emërtimi i një institucioni prestigjioz kulturor ose i një veprimtarie kulturore me emrin e poetit Ali Podrimja.

Me këtë rast, Akademia e konsideron të nevojshme të theksojë se poeti Ali Podrimja ishte njëri nga shkrimtarët dhe poetët më të njohur të letërsisë shqipe, poeti emblematik i Kosovës, dhe se poezia e tij tashmë është pjesë e trashëgimisë letrare dhe kulturore mbarëshqiptare. Vlerat e veprës së Podrimjes konsiderohen të qëndrueshme dhe ato do t'ju shërbejnë brezave të ardhshëm për edukim kulturor kombëtar. Kosova ishte kryefjala e çdo preokupimi të tij krijues dhe intelektual, kështu që nga kjo pikëpamje institucionet e Kosovës do të duhej të përmbushnin një obligim moral ndaj poetit.

Zoti Ministër,

Lidhur me emërtimin e një veprimtarie kulturore ose të një institucioni me emrin e poetit Ali Podrimja, Akademia është e gatshme të bashkëpunojë me organet përkatëse të Ministrisë së Kulturës, në mënyrë që për këtë qëllim të gjendet zgjidhja më e mirë. Njëkohësisht, e konsiderojmë të nevojshme të kërkojmë shqyrtimin me prioritet të kësaj kërkesë, në mënyrë që vonesat eventuale të mos i japin kuptimin e harresës një çështjeje me interes si për Akademinë, ashtu edhe për Ministrinë.

Me respekt,

Akademik Hivzi Islami,

Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës